

L I G J I
I QARKULLIMIT PAGESOR¹
(Tekst i konsoliduar jozyrtar)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet qarkullimi pagesor në vend (në tekstin e mëposhtëm: qarkullimi pagesor), marrëdhëniet midis bartësve të qarkullimit pagesor dhe pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor, marrëdhëniet midis bartësve të qarkullimit pagesor dhe Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pjesën e qarkullimit pagesor, sistemet pagesore, shlyerjet e pagesave, dhënia e parave elektronike dhe mbikëqyrja e sistemeve pagesore.

Neni 2

Nocionet e caktuara të përdorura në këtë ligj, kanë kuptimin në vijim:

1. **"Qarkullimi pagesor"** janë pagesat në denarë të cilat i kryejnë pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor nëpërmjet bartësve të qarkullimit pagesor;
2. **"Pjesëmarrës në qarkullimin pagesor"** është personi i vendit apo i huaj, juridik apo fizik, i cili kryen veprimtari të regjistruar, ose person tjetër fizik i cili bën pagesa në denarë nëpërmjet bartësve të qarkullimit pagesor;
3. **"Pagesë"** është arkëtimi i parave të gatshme në llogari transaksioni, bartja e mjeteve nga një llogari transaksioni në llogari tjetër transaksioni dhe pagesa e parave të gatshme nga llogaria e transaksionit;
4. **"Llogari transaksioni"** është llogaria e cila paraqet të dhënë unike të papërsëritshme numerike, e cila shërben për identifikimin e pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor, nëpërmjet të cilës i njëjti bën pagesa;
5. **"Llogari e bllokuar transaksioni"** është llogari transaksioni, e pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor për të cilin ka të evidentuar aktvendim të pa zbatuar për pagesë të detyruar;
6. **"Instrument pagesor"** është urdhërpagesa me të cilën pjesëmarrësi në qarkullimin pagesor i urdhëron bartësit të qarkullimit pagesor të kryejë pagesë;
7. **"Përmbajtja e instrumentit pagesor"** është përmbledhje e elementëve të instrumentit pagesor që bart informata për identifikimin dhe për zbatimin e saj;
8. **"Medium për bartje"** është bartësi i informatave që përmban instrument pagesor dhe mundëson që instrumenti pagesor të jetë në qasje në periudhë të përcaktuar kohore;
9. **"Forma e instrumentit pagesor"** është renditja e elementëve të instrumentit pagesor;
10. **"Aktvendim për pagesë të detyrueshme"** është urdhërpagesë për zbatim nga përmblyesi, vendim gjyqësor i formës së prerë i lejes së ekzekutimit, kambial, aktvendim përmblyes për dënim për kundërvajtje, aktvendim përmblyes për pagesën e detyrimeve publike ose aktvendim i organeve tjera të autorizuara me ligj²;
11. **"Pagesë me përlllogaritje"** paraqet shlyerjen e ndërsjellë të obligimeve dhe kërkesave në para midis pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor me kompensim, asignim, cedimi, marrje të borxhit dhe forma të tjera të shlyerjes të ndërsjellë të obligimeve dhe kërkesave;

¹ Ky tekst i konsoliduar është përpiluar nga Ligji i Qarkullimit Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, 35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/ 13, 153/15, 199/15, 193/17, 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 31/20 dhe nr. 39/22).

² Në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Qarkullimit Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 59/12) fjala "kambial" nga neni 2 pika (10) do të zbatohet nga 1 shtatori 2012.

12. **"Mikropagesë"** është pagesa e produkteve dhe shërbimeve në shumë individuale jo më të lartë se 1000 denarë, me ç'rast pajtimi që të bëhet pagesa jepet nëpërmjet mjeteve për telekomunikim, aparateve digjitale apo teknologjike-informatike;
13. **"Ndërmjetësues gjatë mikropagesës"** është operatori i telekomunikimit ose i rrjetit, ose operatori i sistemeve teknologjike informatike nëpërmjet të cilit kryhen mikropagesat dhe i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj;
14. **"Shfrytëzuesi i mikropagesës"** është personi fizik ose juridik i cili ka nënshkruar marrëveshje për mikropagesë me ndërmjetësues gjatë mikropagesës, ndërsa nëse personi juridik ka nënshkruar marrëveshje për mikropagesë në emër të më shumë personave fizik, me shfrytëzues të mikropagesës, nënkuptohet çdo person fizik individualisht, përkatësisht çdo linjë parapaguese individualisht;
15. **"Cikël i përlllogaritjes"** është periudha në të cilën ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës kryen përlllogaritje të transaksioneve të kryera nga ana e shfrytëzuesit të pagesës që nuk mund të jetë më e shkurtër se 28 ditë dhe më e gjatë se 31 ditë;
16. **"Finaliteti i pagesës"** është momenti kur pranuesi i mjeteve mund të disponojë me ato;
17. **"Mjetet e disponueshme"** janë të gjitha mjetet në llogari transaksioni në denarë dhe në deviza të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor- debitorit, të bartësi i qarkullimit pagesor prej të cilit realizohen aktvendimet për pagesë të detyruar, përveç mjeteve në llogari me dedikim të veçantë të cilat janë të ndara në pajtim me ligjin ose dispozitat e miratuara në bazë të ligjit dhe mjetet e lejuara në bazë të marrëveshjes me bankën për bilancin negativ të lejuar të llogarisë;
18. **"Para elektronike"** janë vlerë parash të paraqitura si kërkesë e emetuesit që janë: të vendosura në aparat elektronik, të lëshuara në bazë të pranimit të parave në shumë që nuk është më e vogël se vlera e parave elektronike të lëshuara dhe është pranuar si mjet pagese nga ana e personave që nuk janë emetues të atyre parave;
19. **"Llogari e Thesarit"** është llogari transaksioni që përmban sistem të llogarive që mbahen në Librin kryesor të Thesarit;
20. **"Llogaria shëndetësore e thesarit"** është llogari transaksioni e cila përmban sistem llogarish që udhëhiqen në Librin Kryesor Shëndetësor, dhe
21. **"Mbikëqyrje e sistemit pagesor"** është funksion që është i orientuar drejt arritjes së qëllimeve lidhur me sigurinë dhe efikasitetin e sistemeve pagesore nëpërmjet procesit të përcjelljes së aranzhmaneve ekzistuese dhe atyre të planifikuara, duke vlerësuar ato përkundër qëllimeve dhe politikave.³

II. BARTËSIT E QARKULLIMIT PAGESOR

Neni 3

Bartës të qarkullimit pagesor janë Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm Banka Popullore), bankat që kanë marrë pëlqim për kryerjen e qarkullimit të pagesave në pajtim me ligjin dhe filialet e bankave të huaja, dhe Thesari pranë Ministrisë së Financave (në tekstin e mëtejshëm Trezori), si bartës i veçantë i qarkullimit të pagesave për shfrytëzuesit buxhetor dhe njësitë shfrytëzuese dhe Thesari i Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë së Veriut, si bartës i veçantë i qarkullimit pagesor të institucioneve shëndetësore (në tekstin e mëtejshëm: Thesari i Fondit).

Neni 4

Bartësi i qarkullimit pagesor është i detyruar të sigurojë:

- 1) llogari të vetme të transaksionit për shlyerje në Bankën Popullore;
- 2) numër kryesor nëpërmjet të cilit mund të identifikohet;
- 3) shlyerje të instrumenteve pagesore të pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor gjatë ditës, së paku në fund të ditës, në pajtim me planin e terminit të sistemit për shlyerje të Bankës Popullore;

³ Pikat e mbetura (15, 16 dhe 17) janë lënë jashtë në amendamentin e publikuar në ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 166/12).

- 4) rregulla dhe procedura për shfrytëzimin e shërbimeve të cilat ua ofron pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor;
- 5) barazi dhe trajtim të njëjtë të të gjithë pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor;
- 6) siguri dhe qasje operative;
- 7) procedura për përfundimin në kohë të përpunimit, në rast të problemeve teknike;
- 8) fshehtësi të të dhënave për gjendjen e llogarisë së transaksionit në pajtim me ligjin;
- 9) mbrojtjen e të dhënave për pronarin e llogarisë së transaksionit;
- 10) bartje të sigurt dhe efikase të mjeteve midis pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor, dhe
- 11) informim të pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor për gjendjen dhe për ndryshimet e llogarive të tyre të transaksionit, më së voni ditën e ardhshme të punës pas paraqitjes së ndryshimit.

Neni 5

Banka Popullore, si bartëse e qarkullimit pagesor, i kryen punët në vijim:

- 1) organizon sistemin për shlyerje midis bartësve të qarkullimit pagesor;
- 2) hap dhe mban llogari transaksioni të bankave, llogari depozitimi të shoqërive brokere dhe llogari të tjera që me ligj është përcaktuar që të mbahen në Bankën Popullore dhe bën pagesa nga llogaritë;
- 3) hap dhe mban llogaritë të tjera transaksioni, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe;
- 4) hap dhe mban llogari të trezorit;
- 5) mban llogari për llogaritë të transaksionit për operatorët e sistemeve pagesore;
- 6) përcakton standard për konstruksionin e llogarive të pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor;
- 7) jep numër evidentues, bartësve të qarkullimit pagesor;
- 8) e përcakton shumën e pagesës, e cila është pagesë e vogël ndërbankare;
- 9) mban regjistër të llogarive të transaksionit në sistemin e vet;
- 10) realizon aktvendime për pagesa të detyruara që kanë të bëjnë me llogaritë e transaksionit që i mban, dhe
- 11) e rregullon menyrën e mbajtjes dhe përmbajtjen e regjistrit të vetëm të llogarive të transaksionit.

Neni 6

Bankat dhe filialet e bankave të huaja si bartëse të qarkullimit pagesor i kryejnë punët në vijim:

- 1) hapin dhe mbajnë llogari të transaksioneve të pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor dhe kryejnë pagesa nga llogaritë;
- 2) mbajnë regjistër të llogarive të transaksioneve në sistemin e tyre, dhe
- 3) realizojnë aktvendime për pagesa të detyrueshme që kanë të bëjnë për llogaritë e transaksionit që i mbajnë.

Neni 7

(1) Thesari, si bartës i veçantë i qarkullimit pagesor përveç operimeve të përcaktuara nga neni 38 i Ligjit të Buxheteve i kryen punët në vijim:

- 1) hap dhe mban llogari të shfrytëzuesve buxhetor, njërive shfrytëzuese dhe të institucioneve të tjera në pajtim me ligjin;
 - 2) mban regjistër të llogarive në sistemin e tij;
 - 3) i kryen pagesat e llogarive në suazat e Librit kryesor të Thesarit përmes llogarisë së Thesarit;
 - 4) obligon llogarinë suazat e llogarisë së Thesarit në baze autorizimeve të kontraktuara;
 - 5) obligon llogari në suazat e llogarisë së Thesarit në rast të korrigjimit të gabimit nga ana e Thesarit;
- (2) Formën dhe përmbajtjen e formularëve të pagesës që i shfrytëzojnë përdoruesit e buxhetit dhe njësitë shfrytëzuese, si dhe procedurën për korrigjimin e gabimit të bërë gjatë kryerjes së qarkullimit pagesor, i përcakton Ministri i Financave.

Neni 7-a

(1) Thesari i Fondit si bartës i veçantë i qarkullimit pagesor të institucioneve shëndetësore, përveç punëve të përcaktuara me nenin 69-gj të Ligjit të sigurimit shëndetësor, i kryen edhe punët në vijim:

- 1) hap dhe mban llogari të institucioneve shëndetësore;
 - 2) mban regjistrë të llogarive në sistemin e tij;
 - 3) kryen pagesë të llogarive në kuadër të Librit kryesor shëndetësor nëpërmjet Llogarisë shëndetësore të Thesarit;
 - 4) ngarkon llogari në kuadër të Llogarisë shëndetësore të thesarit në bazë të autorizimeve të kontraktuara, dhe
 - 5) ngarkon llogari në kuadër të Llogarisë shëndetësore të thesarit në rast të përmirësimit të gabimit nga ana e Thesarit të Fondit.
- (2) Formën dhe përmbajtjen e formularëve të pagesës që i shfrytëzojnë institucionet shëndetësore, si dhe procedurën për përmirësimin e gabimit të bërë gjatë kryerjes së qarkullimit pagesor, i përcakton Ministri i Financave.

Neni 8

- (1) Aktvendimet për pagesë të detyruar të cilat e ngarkojnë llogarinë e thesarit ose llogarinë shëndetësore të thesarit, përkatësisht llogarinë e debitorit i cili gjendet në kuadër të Librit kryesor të Thesarit ose Librit kryesor shëndetësor, Banka Popullore i zbaton ashtu që për të njëjtat përgatit urdhëresa për zbatim, të cilat i dorëzon për zbatim deri te Thesari ose Thesari i Fondit.
- (2) Mënyrën e zbatimit të urdhëresave nga paragrafi (1) i këtij neni, kur janë të ngarkuara Llogaria e Thesarit ose Llogaria shëndetësore e thesarit, përkatësisht llogaria e debitorit e cila gjendet në kuadër të Llogarisë së thesarit ose Llogarisë shëndetësore të thesarit, e përcakton Ministri i Financave.

Neni 9

- (1) Thesari ose Thesari i Fondit i informon operatorët e sistemeve pagesore për llogaritë të cilat udhëhiqen në Librin kryesor të Thesarit ose në Librin kryesor shëndetësor.
- (2) Shtëpia e klirimit e cila e mban regjistrin e vetëm të llogarive të transaksionëve i dorëzon të dhënat nga i njëjti në Trezor ose Trezorit të Fondit.

III. KRYERJA E PUNËVE TË QARKULLIMIT PAGESOR

Neni 10

- (1) Qarkullimi pagesor realizohet kryesisht përmes llogarive të transaksionit që janë të lajmëruar në Regjistrin e Vetëm të llogarive të transaksionit.
- (2) Nuk lejohet pagesa midis pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor që nuk bëhet përmes llogarive të transaksionit.

Neni 11

Bartësi i qarkullimit pagesor do t'i lejojë pjesëmarrësit pagesën e rrogës në sistemin pagesor vetëm nëse për të njëjtën paraprakisht është paguar tatimi dhe kontributet.

Neni 12

- (1) Bartësi i qarkullimit pagesor, për realizimin e punëve në qarkullimin pagesor hap llogari transaksioni të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor me kërkesë të tijën me shkrim.
- (2) Pjesëmarrësi në qarkullimin pagesor mund të ketë më shumë llogari transaksioni të një bartësi të qarkullimit pagesor.
- (3) Pjesëmarrësi në qarkullimin pagesor mund të ketë llogari transaksioni të më shumë bartësve të qarkullimit pagesor.

(4) Mënyra dhe procedura e hapjes dhe mbylljes së llogarisë së transaksionit sipas paragrafit (1) të këtij neni, përcaktohet nga guvernatori i Bankës Popullore.

Neni 13

(1) Bartësi i qarkullimit pagesor e mbyll llogarinë e transaksionit të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor me kërkesë të tij me shkrim, në pajtim me rregulloren nga neni 12, paragrafi (4) të këtij Ligji.

(2) Me perjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, bartësi i qarkullimit pagesor e mbyll llogarinë e transaksionit të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor edhe pa kërkesë të tij me shkrim nëse pjesëmarrësi në qarkullimin pagesor është subjekt jo aktiv, shlyerja e të cilit në pajtim me ligjin është shpallur në ueb faqen e Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Nëse pjesëmarrësi në qarkullimin pagesor pushon së ekzistuari si subjekt juridik në bazë të ligjit, vendimit gjyqësor ose me urdhër të organit kompetent, bartësi i qarkullimit pagesor e mbyll llogarinë e transaksionit të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor.

(4) Llogarinë e transaksionit që nuk ka bilanc dhe ndryshime në dy vitet e fundit dhe nuk është e bllokuar, bartësi i qarkullimit pagesor është i obliguar ta mbyllë, për çfarë në mënyrë të obligueshme e njofton pjesëmarrësin në qarkullimin pagesor.

Neni 14

Pjesëmarrësi në qarkullimin pagesor është i detyruar për ndryshimet statusore të paraqitura me shkrim t'i informojë bartësitë qarkullimit pagesor të të cilat ka llogari transaksioni më së voni tre ditë nga dita e marrjes së aktvendimit për ndryshimet statusore dhe ndryshimet tjera.

Neni 15

(1) Bartësi i qarkullimit pagesor është i detyruar që të dhënat për ndryshimet në regjistrin e tij të llogarivetë transaksionit t'i dorëzojë në regjistrin e vetëm të llogarive të transaksionit të njejtën ditë, më së voni deri në fund të orarit të punës të regjistrat të vetëm të llogarive të transaksionëve.

(2) Të dhënat për ndryshimet në regjistrin e llogarive të transaksioneve, regjistrin e vetëm të llogarive të transaksioneve i dorëzon në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në afatin e caktuar në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Regjistrin e Vetëm të llogarive të transaksionëve e mban shtëpia kliring të cilën e përcakton Ministria e Financave.

Neni 16

Të dhënat nga regjistri i vetëm i llogarive të transaksioneve mund të shfrytëzohen në kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe me ligj tjetër.

Neni 17

(1) Për kryerjen e qarkullimit pagesor shfrytëzohen instrumente pagesore.

(2) Forma e instrumenteve pagesore të medimeve për bartje paraqet lëndë marreveshjeje midis bartësit të qarkullimit pagesor dhe pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor.

(3) Instrumentet pagesore dhe përmbajtja dhe forma e tyre, përveç formës së instrumenteve pagesore të përfshira në medimet për bartje, i përcakton ministri i Financave.

Neni 18

(1) Pagesa nëpërmjet llogarive të transaksionit bëhet në bazë të instrumentit pagesor.

(2) Instrument pagesor në barrë të llogarisë mund të leshojë:

1) pjesëmarrësi i qarkullimit pagesor-mbajtësi i llogarisë;

2) bartësi i qarkullimit pagesor, në bazë të autorizimeve të kontraktuara dhe aktvendimeve për pagesë të detyruar;

- 3) bartësi i qarkullimit pagesor për korrigjimin e gabimit të bërë nga bartësi i qarkullimit pagesor, me përjashtim të llogarisë së Thesarit;
 - 4) thesari pranë Ministrisë së Financave, për llogaritë në suazat e llogarisë së Thesarit, dhe
 - 5) thesari i Fondit për llogaritë në kuadër të llogarisë shëndetësore të thesarit.
- (3) Procedurën për korrigjimin e gabimit të bërë nga bartësi i qarkullimit pagesor nga paragrafi (2) pika tre e këtij neni, e përcakton guvernatori i Bankës Popullore.

Neni 19

- (1) Pagesa sipas instrumentit pagesor bëhet nëse llogaria e transaksionit në barrë të së cilës jepet instrumenti pagesor, ka mbulesë.
- (2) Me mbulesë të llogarisë se transaksionit nënkuptohet gjendja e llogarisë së transaksionit të ditës së kaluar e zmadhuar për hyrjen e mjeteve gjatë ditës dhe për mjetet e lejuara në bazë të marrëveshjes me bankën për bilancin negativ të lejuar të llogarisë, e zvogëluar për pagesat gjatë ditës deri në momentin e përcaktimit të mbulesës.

Neni 20

- (1) Pjesëmarrësi në qarkullimin pagesor mundet që për pagesë me para të gatshme të tërheqë nga llogaritë dhe të ruajë në arkën e vet para të gatshme në lartësinë e maksimumit të arkës.
- (2) Lartësinë e maksimumit të arkës e cakton pjesëmarrësi në qarkullimin pagesor me akt të veçantë.
- (3) Pjesëmarrësi i qarkullimit pagesor – person juridik është i detyruar që të gjitha mjetet në para të tregut ditor të bërë me para të gatshme në çfarëdo baze t'i arkëtojë më së voni ditën e ardhshme në llogarinë e vet të transaksioni.
- (4) Pagesa e produkteve dhe e shërbimeve me para në dorë nga ana e personave juridike nuk mund të jetë më shumë se 6.000 denarë.

Neni 21

- (1) Bartësi i qarkullimit pagesor është i detyruar që t'i realizojë aktvendimet për pagesë të detyruar në pajtim me ligjin. Bartësi i qarkullimit pagesor është i detyruar që të veprojë sipas aktvendimeve për pagesë të detyruar më së voni ditën e ardhshme nga dita e pranimi të aktvendimit.
- (2) Aktvendimet për pagesë të detyruar evidentohen në evidencë sipas datës dhe kohës së arritjes së tyre dhe sipas të njejtës radhitje realizohen.

Neni 22

- (1) Aktvendimi për pagesë të detyruar dorëzohet te bartësi i qarkullimit pagesor të shënuar në aktvendimin për pagesë të detyruar.
- (2) Bartësi i qarkullimit pagesor e realizon aktvendimin për pagesë të detyruar nëse janë shënuar saktë të dhënat prej ku mund me siguri të identifikohen të gjitha elementët e aktvendimit. Në të kundërtën, ia kthen organit që e ka dhenë, përkatësisht, kreditorit që e ka parashtruar aktvendimin për ta precizuar.⁴
- (3) Bartësi i qarkullimit pagesor e realizon aktvendimin për pagesë të detyruar nga të gjitha mjetet disponuese, të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor-debitor te bartësi i qarkullimit pagesor.
- (4) Nëse pjesëmarrësi i qarkullimit pagesor– debitor në llogari në denarë nuk ka mjete për realizimin e plotë të aktvendimit për pagesë të detyruar, bartësi i qarkullimit pagesor me përdorimin e kursit mesatar të Bankës Popullore që vlen në ditën e transaksionit, bën konvertimin në kundërvlerë në denarë të mjeteve të llogarisë devizore dhe bartje në llogari denarë të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor-debitor deri në shumën e duhur për realizimin e plotë të aktvendimit për pagesë të detyruar.

⁴ Në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Qarkullimit Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 59/12), fjalët "respektivisht kreditori që ka paraqitur" nga neni 22, paragrafi (2) do të do të zbatohet nga 1 shtatori 2012.

(5) Në rast të mungesës së mjeteve për realizimin e plotë të aktvendimit për pagesë të detyruar, bartësi i qarkullimit pagesor e realizon aktvendimin deri në lartësinë e mjeteve disponuese dhe e bllokoi llogarinë dhe me dorëzimin e numrit tatimor– debitor nëpërmjet regjistrit të vetëm të llogarive të transaksionit i informon të gjithë bartësit e qarkullimit pagesor se nuk guxojnë të realizojnë pagesa nga mjetet e llogarisë në denarë në llogari devizore pjesëmarrësit– debitor deri në realizimin e plotë të aktvendimit, përveç urdhërpagesave me të cilat bëhet bartja e mjeteve në llogari të bartësi i qarkullimit pagesor që duhet ta realizojë aktvendimin për pagesë të detyruar.

(6) Pas përmbushjes së obligimeve sipas aktvendimit për pagesë të detyruar, bartësi i qarkullimit pagesor bën deblokimin e llogarisë së transaksionit për çka nëpërmjet regjistrit të vetëm të llogarive të transaksionit i informon të gjithë bartësit e qarkullimit pagesor.

(7) Bartësi i qarkullimit pagesor mund të bëjë qarkullim pagesor për pjesëmarrësin debitor nëse nuk ka aktvendime tjera të evidentuara për pagesë të detyruar.

Neni 23

Nëse pjesëmarrësi i qarkullimit pagesor në ditën e skadimit të marrëveshjes për afatizim të mjeteve të veta te banka, ka llogari të transaksionit të bllokuar, banka nuk mund ta vazhdojë marrëveshjen për afatizimin e mjeteve. Banka të cilat mbahen mjetet e afatizuara të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor e cila llogari është e bllokuar, është e detyruar në ditën e skadimit të marrëveshjes për afatizim të mjeteve, mjetet t'i bartë në llogarinë e transaksionit të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor.

Neni 24

Nëse llogaria e transaksionit të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor është e bllokuar pa ndërprerë më shumë se 45 ditë, bartësi i qarkullimit pagesor nëpërmjet regjistrit të vetëm për llogari të transaksionit e informon Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 25

(1) Pjesëmarrësi i qarkullimit pagesor nuk mund të bëjë pagesë me llogaritje nëse ka llogari të bllokuar të transaksionit.⁵

(2) Shfrytëzuesit buxhetor, njësitë shfrytëzues dhe institucionet tjera që kanë llogari në Librin kryesor të Trezorit nuk mund të bëjnë pagesë me llogaritje nëse kanë llogaritje bllokuar.

(3) Institucionet shëndetësore publike të cilat kanë llogari në Librin kryesor shëndetësor nuk mund të kryejnë pagesë me llogaritje nëse kanë llogari të bllokuar.

Neni 26

(1) Bartësi i qarkullimit pagesor mund të bëjë pagimin e kompensimeve për kryerjen e punëve në qarkullimin pagesor sipas tarifës të cilën e përcakton bartësi i qarkullimit pagesor.

(2) Bartësi i qarkullimit pagesor është i detyruar që ta shpall tariforin në vend të dukshëm në lokalet e veta dhe në faqen e vet të internetit.

Neni 27

Bartësi i qarkullimit pagesor me kërkesë të pjesëmarrësve dhe të pjesëmarrësve potenciale në qarkullimin pagesor është i detyruar që t'u japë informata paraprake për kushtet e kryerejes së

⁵ Në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Qarkullimit Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 199/15), dispozita e nenit 25, paragrafi (1) do të zbatohet nga 31 dhjetori 2017.

Në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Qarkullimit Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.193/17), dispozita e nenit 25, paragrafi (1) nga 31 dhjetori 2018.

Në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Qarkullimit Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.7/19), dispozita e nenit 25, paragrafi (1) nga data 31 dhjetori 2019.

Në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Qarkullimit Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.31/20), dispozita e nenit 25, paragrafi (1) 31 dhjetori 2021.

Në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Qarkullimit Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 39/22), dispozita e nenit 25, paragrafi (1) 31 dhjetori 2022.

qarkullimit pagesor. Informatat duhet të jenë në formë të kuptueshme dhe t'i përmbajnë se paku të dhënat në vijim:

- 1) mënyrën e përcaktimit të kompensimeve që pjesëmarrësi i qarkullimit pagesor duhet t'ia paguajë bankës për transaksionet e bëra (depozitimin e parave të gatshme, marrjen e parave të gatshme ose transferimin prej llogarisë ose në llogari);
- 2) kohën për të cilën do të lejohet banka e shfrytëzuesit të transferit pas marrjes së urdherpagesës, në rast të referimit të mjeteve, respektivisht kohën kur është lejuar banka, në rast të hyrjes së mjeteve në llogari, dhe
- 3) mënyrën dhe procedurën për realizimin e të drejtës së kundërshtimit dhe të kompensimit për realizim dhe të mosrealizimit në kohë, që i janë dhënë në disponim pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor dhe mënyra se si duhet t'i realizojë ato të drejta.

III-a. MIKROPAGESA

1. Kushtet për kryerjen e shërbimit të mikropagesës

Neni 27-a

- (1) Ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës duhet të ketë themeluar kryegjë e cila në secilin moment arrin më së paku 3.000.000 denarë dhe i plotëson standardet teknike për kryerjen e mikropagesave.
- (2) Urdhëri për kryerjen e mikropagesës jepet nëpërmjet aparateve të telekomunikimit, digjitale ose teknologjiko-informatike, ndërsa pagesën e bën ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës, që vepron ekskluzivisht si ndërmjetësues ndërmjet shfrytëzuesit të mikropagesës dhe furnizuesit të produkteve dhe mallrave me të cilin ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës ka lidhur marrëveshje.
- (3) Transaksionet e përgjithshme në një cikël të përlogaritjes për një shfrytëzues të mikropagesës të një ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës nuk guxojnë të tejkalojnë shumën prej 6 000 denarë.
- (4) Transaksionet e përgjithshme mujore të të gjithë shfrytëzuesve të mikropagesës të një ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës nuk guxojnë të tejkalojnë shumën prej 100 000 000 denarë.
- (5) Mjetet që shfrytëzuesi i mikropagesës i paguan të ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës nuk konsiderohen si depozitë sipas dispozitave të Ligjit për Banka, e as nuk konsiderohen si para elektronike sipas dispozitave të këtij ligji.
- (6) Kryerja e mikropagesës rregullohet me marrëveshje të nënshkruar nga shfrytëzuesi i mikropagesës dhe ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës.
- (7) Ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës detyrohet së paku një herë në muaj t'i parashtrojë shfrytëzuesit të mikropagesës, pa kompensim, raport për mikro-pagesat e kryera edhe për shpenzimet për çdo mikropagesë në mënyrë dhe formë të rregulluara me marrëveshjen nga paragrafi (6) i këtij neni.

2. Pëlqimi për ndërmjetësues gjatë mikropagesës

Neni 27-b

- (1) Personi i cili ka për qëllim të jetë ndërmjetësues gjatë mikropagesës në pajtim me këtë ligj, parashtron kërkesën e Bankës Popullore për marrjen e pëlqimit për kryerjen e mikropagesës.
- (2) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrihen dokumentet, të dhënat dhe informatat në vijim:
 - 1) emri, selia dhe adresa e personit i cili ka për qëllim të jetë ndërmjetësues gjatë mikropagesës dhe të dhëna për personin përgjegjës të personit juridik;
 - 2) dëshmi se personi juridik i cili ka për qëllim të jetë ndërmjetësues gjatë mikropagesës ka kryegjë bazike prej së paku 3 000 000 denarë;
 - 3) dëshmi se janë plotësuar standardet teknike për kryerjen e mikropagesës të cilat kanë të bëjnë sëpaku me: sigurinë dhe qasjen operative, transferin e sigurt dhe efikas të mjeteve ndërmjet shfrytëzuesit të mikropagesës dhe furnizuesit të produkteve dhe shërbimeve me të cilin ndërmjetësuesi i mikropagesës ka lidhur marrëveshje;
 - 4) rregulla dhe procedura për kryerjen e mikropagesës dhe për ndjekjen dhe respektimin e limiteve për shumat e lejuara të mikropagesës;

- 5) procedura për përfundim në kohë të përpunimit në rast të problemeve teknike dhe
- 6) program për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, i përpiluar në pajtim me Ligjin për parandalimin e larjes së parave dhe të hyrave tjera nga vepra e ndëshkueshme dhe financimit të terrorizmit.
- (3) Për kërkesën për dhënien e pëlqimit për kryerjen e mikropagesës, vendos guvernatori në afat prej 60 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.
- (4) Guvernatori e hedh poshtë kërkesën e pakompletuar për dhënien e pëlqimit nga paragrafi (1) i këtij neni.
- (5) Guvernatori e refuzon kërkesën për dhënie të pëlqimit nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse:
 - 1) kërkesa nuk e përmban dokumentacionin e kompletuar nga paragrafi (2) i këtij neni;
 - 2) kërkesa përmban të dhëna të pasakta apo të pavertëta dhe
 - 3) nga dokumentet, të dhënat dhe informatat e parashtruara rezulton se nuk janë plotësuar kushtet e lidhura me standardet teknike për kryerjen e mikropagesës ose kushtet në lidhje me shumat e lejuara të mikropagesës, të përkufizuara me këtë ligj.
- (6) Standardet teknike nga paragrafi (2), pika 3 i këtij neni më hollësisht i përcakton Këshilli i Bankës Popullore.
- (7) Dokumentacionin, të dhënat dhe informatat me të cilat vërtëtohet plotësimi i kushteve nga paragrafi (2) i këtij neni, mënyrën e parashtrimit të tyre dhe mënyrën e vlerësimit të tyre, i përcakton Këshilli i Bankës Popullore.

Neni 27-c

- (1) Ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës detyrohet që në formë me shkrim ta njoftojë Bankën Popullore për çdo ndryshim në dokumentacionin, informatat dhe të dhënat nga neni 27-b paragrafi (2) i këtij neni, me arsytim për shkaqet për të cilat është bërë ndryshimi.

3. Regjistri i ndërmjetësuesve gjatë mikropagesës

Neni 27-ç

- (1) Banka Popullore mban Regjistër të ndërmjetësuesve gjatë mikropagesës.
- (2) Guvernatori i Bankës Popullore i përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit të ndërmjetësuesve gjatë mikropagesës.

4. Njoftimi

Neni 27-d

- (1) Për dhënien dhe heqjen e pëlqimit për kryerjen e mikropagesës Banka Popullore e njofton Ministrinë e Financave në afat prej pesë ditësh pune nga dita e dhënies dhe heqjes së pëlqimit.
- (2) Njoftimi nga paragrafi (1) i këtij neni, përmban:
 - 1) emrin, selinë dhe adresën e ndërmjetësuesit gjatë mikropagesës;
 - 2) të dhëna për personin përgjegjës të ndërmjetësuesit gjatë mikropagesës;
 - 3) datën e dhënies, përkatësisht heqjes së pëlqimit ndërmjetësuesit gjatë mikropagesës dhe
 - 4) shkaqet për tërheqjen e pëlqimit për ndërmjetësues gjatë mikropagesës.

5. Mbikëqyrje mbi ndërmjetësuesit gjatë mikropagesës

Neni 27-dh

- (1) Mbikëqyrjen mbi punën e ndërmjetësuesve gjatë mikropagesës e kryen Banka Popullore, në sferën e:
 - 1) përcaktimit të plotësimit të standardeve teknike për kryerjen e mikropagesës nga neni 27-b, i këtij ligji dhe
 - 2) përcaktimit të respektimit të limiteve për transaksion të veçantë edhe për transaksionet e përgjithshme mujore gjatë mikropagesës.
- (2) Mbikëqyrjen nga paragrafi (1) i këtij neni, Banka Popullore mund ta kryejë nëpërmjet ndjekjesve jashtë terrenit të punës së ndërmjetësuesit gjatë mikro-pagesave ose nëpërmjet

kontrolleve në terren tek ndërmjetësuesi gjatë mikro-pagesave, në pajtim me aktet interne të Bankës Popullore.

(3) Ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës detyrohet nga Banka Popullore të dorëzojë raporte për mikropagesat e kryera.

(4) Formën dhe përmbajtjen e raporteve dhe dinamikën e dorëzimit të tyre e përcakton Këshilli i Bankës Popullore.

Neni 27-e

Gjatë kontrolleve në terren ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës detyrohet që personit të autorizuar të Bankës Popullore t'i mundësojë punë të pa penguar të mbikëqyrjes, qasje në punën dhe me kërkesë të tij t'i vë në dispozitim dokumentacionin, informatat dhe të dhënat e tërësishme.

Neni 27-ë

(1) Për veprime të ndërmarra në procedurën e kontrollit në teren personi i autorizuar i Bankës Popullore përpilon procesverbal.

(2) Ndërmjetësuesi gjatë mikropagesës ka të drejtë për kundërshtim të procesverbalit në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të procesverbalit nga Banka Popullore.

Neni 27-i

Ndaj ndërmjetësuesit gjatë mikropagesës për të cilin do të konstatohet se nuk punon në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Banka Popullore mund t'i ndërmarrë masat në vijim:

- 1) të dorëzojë paralajmërim me shkrim ose rekomandim me shkrim;
- 2) të japë urdhër me shkrim dhe të caktojë afat për harmonizimin e punës dhe akteve me dispozitën e këtij ligji dhe rregulla të përcaktuara në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe
- 3) ta tërheqë pëlqimin për ndërmjetësues gjatë mikropagesës.

Neni 27-j

Guvernatori i Bankës Popullore me aktvendim ia tërheq pëlqimin ndërmjetësuesit gjatë mikropagesës nëse konstaton se:

- 1) më gjatë se gjashtë muaj nuk kryen shërbim të ndërmjetësuesit gjatë mikropagesës;
- 2) pëlqimi për kryerjen e shërbimit ndërmjetësues gjatë mikropagesës është marrë në bazë të dokumenteve, të dhënave dhe informatave të pavetëta dhe të rrejshme;
- 3) me tëj nuk i plotëson kushtet për kryerjen e shërbimit ndërmjetësues gjatë mikropagesës të përcaktuara me këtë ligj dhe rregulla të miratuara në bazë të këtij ligji me çfarë është rrezikuar siguria gjatë kryerjes së mikropagesës;
- 4) nuk i përcakton ose vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të dispozitave të këtij ligji me çfarë është rrezikuar siguria gjatë kryerjes së mikropagesës, dhe
- 5) e pengon kryerjen e kontrollit nga Banka Popullore.

Neni 27-k

(1) Nëse Banka Popullore ose organi i autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në pajtim me ligj ka dijeni se persona juridik dhe fizik kryejnë punën e ndërmjetësuesit gjatë mikropagesës pa pëlqim paraprak nga Banka Popullore, menjëherë e njoftojnë Drejtorinë e Policisë Financiare.

(2) Drejtoria e Policisë Financiare detyrohet që menjëherë pas marrjes së njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni, të kryejë kontroll të punës së personave nga paragrafi (1) i këtij neni, dhe të ndërmarrë masa në kuadër të kompetencave të veta.

IV. PARATË ELEKTRONIKE

Neni 28

(1) Emetues i parave elektronike mund të jetë vetëm:

- 1) banka me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut e cila nga guvernatori i Bankës Popullore ka marrë pëlqim paraprak për dhënien e parave elektronike,
 - 2) filial i bankës së vendit anëtar të Bashkimit Europian, në pajtim me Ligjin e Bankave,
 - 3) filiali i bankës se huaj i cili, në pajtim me Ligjin e Bankave, nga guvernatori i Bankës Popullore ka marrë leje për hapje dhe për operim, dhe
 - 4) shoqëria për dhënien e parave elektronike, e cila nga guvernatori i Bankës Popullore ka marrë leje për themelim dhe për punë në pajtim me këtë Ligj.
- (2) Pranimi i mjeteve në para për shkak të dhënies se parave elektronike nuk do të thotë pranimi i depozitës ose i burimeve të tjera kthyesë të mjeteve në kuptim të dispozitave nga Ligji për Bankat, nëse paratë elektronike jepen menjëherë gjatë pranimit të mjeteve në para.

Neni 29

- (1) Paratë elektronike jepen në baze të marrëveshjes për dhënien e parave elektronike të lidhur midis dhenësit të parave elektronike dhe personit fizik- pronar i parave elektronike (në tekstin e mëposhtëm: pronari).
- (2) Në bazë të marrëveshjes nga paragrafi (1) i këtij neni, ndërsa pas pagesës së shumës se caktuar të mjeteve në para, pronarit i jepen para elektronike me të cilat mund të kryejë pagesa në shumë deri në mbulesën e parave elektronike të dhëna.
- (3) Për paratë e dhëna elektronike pronari i paguan dhenësit provizion. Gjatë pagimit me para elektronike nuk paguhet provision ose shpenzime tjera.
- (4) Mbulesa e parave të dhëna elektronike është në shumë të mjeteve në para të arkëtuara, të zvogëluara për shumën e pagesave të bëra dhe provizioneve të paguara.

Neni 30

Përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe në këtë ligj, marrëdhëniet midis dhenësit të parave elektronike dhe pronarit rregullohen në pajtim me dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve Obligative.

2. Të drejtat dhe obligimet e dhenësit dhe pronarit

Neni 31

- (1) Pronari mundet në çdo kohë në periudhë të vlefshmërisë së marrëveshjes për dhënien e parave elektronike të kërkojë nga dhenësi pagimin e mbulesës së parave të dhëna elektronike në vlerë të plotë, në para të gatshme ose me bartje në llogaritë e transaksionit. Paga detyrimisht duhet të bëhet në afat prej se paku tetë ditëve pas pranimit të kërkesës për pagesë.
- (2) Dhenësi i parave elektronike nuk ka të drejtë për pagesën nga paragrafi (1) nga ky nen të paguaje kompensim ose shpenzime të tjera.
- (3) Përgjegjësia për dëmin që mund të lind në lidhje me paragrafët (1) dhe (2) nga ky nen, nuk mund të përjashtohet ose kufizohet kontraktualisht.
- (4) Në marrëveshjen për dhënien e parave elektronike përcaktohen kushtet për pagesë, gjatë se cilës mund të përcaktohet shuma minimale e pagesës që nuk mund të jetë me e vogël se 700 denarë.
- (5) Përgjegjësia për dëmin që mund të lind në lidhje me paragrafët (1) dhe (2) nga ky nen, nuk mund të përjashtohet ose kufizohet kontraktualisht.

Neni 32

Dhenësi i parave elektronike është i detyruar t'i lejoje pronarit qasje në informatat për mbulesën e parave elektronike të dhëna.

Neni 33

- (1) Emetuesi i parave elektronike është përgjegjës para pronarit për shumën e humbur të mbulesës dhe për pagesën e kryer jo të saktë edhe nëse shkak për humbjen e tillë të mbulesës ose të realizimit jo të saktë të pagesës kur edhe ajo është si rezultat i aparatit të dëmtuar në të cilin ruhen paratë elektronike, ose të pajisjes së dëmtuar që nuk është në kontroll direkt, ose në kontroll ekskluziv të dhenësit të parave elektronike.

(2) Emetuesi i parave elektronike mund të lirohet nga përgjegjësia nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse dëshmon se humbja e mbulesës ose realizimi jo i saktë i pagesës është shkaktuar për shkak të pakujdesisë ose veprimit me qëllim të pronarit.

3. Shoqëria për dhënien e parave elektronike

Neni 34

(1) Ndaj Shoqërisë për dhënien e parave elektronike në mënyrë të duhur zbatohen dispozitat nga Ligji për Bankat që kanë të bëjnë me themelimin e bankës (aksionaret, kapitali fillestar, aksionët prioritarë, leja për themeliminë punës, leja për ndryshime statusore dhe regjistrimi në regjistrin tregtar), pjesëmarrja kualifikuese në banke dhe pëlqimet e aksionareve, hapja e filialeve të bankave të Republikës së Maqedonise së Veriut jashtë vendit, për Kuvendin e Bankës, keshillin drejtues dhe mbikëqyres të bankës (pëlqimet, numri i anëtareve, emërimet dhe kompetencat), shërbimi për revizion të brendshëm të bankës, masat (masat e rregullta dhe plotësuese, tërheqja e pëlqimeve, heqja e pëlqimeve për themelim dhe për punë dhe për ndryshime statusore), hapja dhe mbajtja e likuidimit të bankës, për hapjen dhe mbajtjen e procedurës falimentuese të bankës, si dhe dispozitat që kanë të bëjnë me raportet, kontabilitetin dhe revizionin dhe sanksionet kundërvajtëse, nëse me këtë Ligj nuk është përcaktuar më ndryshe.

(2) Mënyrën e zbatimit të dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni të shoqërisë për dhënien e parave elektronike më për së afërmi përcaktohet nga Këshilli i Bankës Popullore.

3.1. Themelimi

Neni 35

(1) Shoqëria për dhënien e parave elektronike themelohet si shoqëri aksionare, sipas lejes së marrë paraprakisht nga guvernatori i Bankës Popullore.

(2) Për themelimin e shoqërisë për dhënien e parave elektronike nevojitet kapital fillestar në para prej sëpaku 70 milionë denarë.

(3) Shoqëria për dhënien e parave elektronike është e detyruar ta mbajë vlerën e kapitalit fillestar nga paragrafi (2) i këtij neni.

3.2 Menaxhimi me rreziqet

Neni 36

Shoqëria për dhënien e parave elektronike detyrimisht duhet të disponojë me mjete personale siç janë definuar në Ligjin për Banka. Mjetet personale nuk guxojnë të zvogëlohen nën shumën e kapitalit fillestar nga neni 35, paragrafi (2) nga ky Ligj, dhe në çdo kohë detyrimisht duhet të jetë së paku 2% nga shuma më e lartë nga gjendja e:

1. bilancin rrjedhëse të të gjitha obligimeve për pagesë që dalin nga dhënia e parave elektronike, ose
2. bilancin mesatar të të gjitha obligimeve për pagesë që dalin nga dhënia e parave elektronike gjatë gjatë muajve të fundit.

Neni 37

(1) Shoqëria për dhënien e parave elektronike është e detyruar të depozitojë mjete në shumë prej së paku në lartësinë e bilancituni rrjedhëse të të gjithë obligimeve sipas dhënies së parave elektronike. Investimi mund të jetë vetëm në mjete me rrezik të ulët dhe të lartë të likuiditetit.

(2) Llojin e mjeteve në të cilat shoqëritë për dhënien e parave elektronike mund ta depozitojnë, vëllimin e depozitimit, në total dhe në lloje të veçanta të mjeteve, metodologjinë për menaxhim me rreziqet që dalin nga dhënia e parave elektronike dhe depozitimet, metodologjinë për vlerësimin e mjeteve të mënyrës dhe përmbajtjes së informatave në lidhje me depozitimet dhe ekspozimet e rreziqeve, i përcakton Keshilli i Bankës Popullore.

3.3. Aktivitetet

Neni 38

- (1) Shoqëria për dhënien e parave elektronike nuk guxon të bëjë aktivitete të tjera përveç dhënies së parave elektronike.
- (2) Me përjashtim të paragrafit (1) nga ky nen, shoqëria për dhënien e parave elektronike mund ta kryejë edhe:
 1. shërbimin financiar dhe jofinanciar lidhur me dhënien e parave elektronike, siç është menaxhimi i parave elektronike nëpërmjet shërbimeve operative dhe shërbimeve të tjera lidhur me dhënien e parave elektronike dhe dhënien e menaxhimit me mjetet tjera pagesë, me përjashtim të lejimit të kredisë në çfarëdo forme, dhe
 2. shërbimin e vendosjes së të dhënave në aparatë elektronike në emër të personave tjerë juridik.
- (3) Shoqëria për dhënien e parave elektronike nuk guxon të ketë dhe të fitojë pjesë kapitale në persona tjerë juridik, përveç në persona juridik që i kryejnë shërbimet nga paragrafi (2) nga këtij neni.

V. SISTEMET PAGESORE

Neni 39

Sistemi pagesor paraqet sistem për bartjen e mjeteve i cili është themeluar me marrëveshje formale dhe standarde dhe me rregulla të përbashketa për përpunimin, ndërhyrjen dhe/ose shlyerjen e pagesave ndërmjet pjesëmarrësve në sistemin pagesor.

Neni 40

- (1) Pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor janë: bartësit e qarkullimit pagesor, shtëpia e klirimit dhe agjentit të shlyerjes.
- (2) Pjesëmarrësit në sistemin pagesor në suazat e sistemit pagesor i kryejnë operimet në vijim:
 - bartësi i qarkullimit pagesor i kryen obligimet financiare të cilat dalin nga instrumentet pagesore në suazat e sistemit pagesor;
 - agjenti i shlyerjes mban llogari për shlyerjen e pjesëmarrësve në sistemin pagesor, dhe
 - shtëpia e klirimit kryen punë të llogaritjes dhe përcaktimin e obligimeve dhe kërkesave të pjesëmarrësve në sistemin pagesor.
- (3) Pjesëmarrësi në sistemin pagesor mund të kryejë aktivitetin e bartësit të qarkullimit pagesor dhe/ose agjentit të shlyerjes dhe/osë shtëpisë së klirimit në sistemin pagesor.
- (4) Një prej pjesëmarrësve në sistemin pagesor përcaktohet për operator të sistemit pagesor, Operatori i sistemit pagesor menaxhon dhe udhëheq me sistemin pagesor.
- (5) Pjesëmarrësi në sistemin pagesor mund të merr pjesë në më shumë sisteme pagesore.

Neni 41

- (1) Sistemi pagesor themelohet me marrëveshje me shkrim për pjesëmarrje në sistemin pagesor midis të gjithë pjesëmarrësve, ose midis operatorit të sistemit pagesor dhe secilit pjesëmarrës.
- (2) Operatori i sistemit pagesor është i detyruar ta paraqes themelimin e sistemit pagesor në Bankën Popullore para fillimit të tij me punë.
- (3) Banka Popullore mund të mbajë llogari për shlyerjen e pjesëmarrësve në sistemet tjera pagesore.
- (4) Pjesëmarrësit në sistemin pagesor mund të themelojnë shtëpi të klirimit të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Maqedonisë së Veriut si shoqëri aksionare.

Neni 42

- (1) Sistemi pagesor detyrimisht duhet të ketë rregulla të përcaktuara nga operator i sistemit pagesor.
- (2) Rregullat e sistemit pagesor janë pjesë e marrëveshjes nga neni 41 të këtij ligji dhe i përcaktojnë së paku punët si në vijim:

- 1) kush është operatori i sistemit pagesor;
- 2) kush mund të jetë pjesëmarrës në sistemin pagesor;
- 3) mënyrën e mbajtjes së llogaritjes dhe shlyerjes;
- 4) të drejtat dhe obligimet e pjesëmarrësve në sistemin pagesor;
- 5) planin e terminit sipas të cilit punon sistemi pagesor;
- 6) koha kur urdhërpagesat në sistem bëhen definitive dhe nuk mund më shumë të tërhiqen;
- 7) mënyrat e këmbimit të urdhërpagesave në sistemin pagesor, dhe
- 8) llojin dhe lartësinë e pagesave të cilat janë bazë e operimit të sistemit pagesor.

Neni 43

(1) Llogaritjen për përcaktimin e obligimeve shtëpia e klirimit mund ta bëjë në një nga mënyrat në vijim:

- 1) nëpërmjet shumës së të gjithë obligimeve të një pjesëmarrësi ndaj pjesëmarrësit tjetër në periudhën llogaritëse (bruto principi), ose
 - 2) si diferencë e të gjitha obligimeve të një pjesëmarrësi dhe të gjitha kërkesat e një pjesëmarrësi nga pjesëmarrësit tjerë në sistem në periudhën e llogaritur (neto principi).
- (2) Llogaritja nga paragrafi (1), pika 2) nga ky nen, mund të bëhet:
- 1) si diferencë e njërit pjesëmarrës prej pjesëmarrësit tjetër (principi bilateral neto) ose
 - 2) si diferencë e njërit pjesëmarrës me të gjithë pjesëmarrësit tjerë (principimul lateral neto).

Neni 44

- (1) Mbikëqyrjen e sistemit pagesor e kryen Banka Popullore.
- (2) Mënyrën dhe metodologjinë e mbikëqyrjes së sistemeve pagesore e përcakton Këshilli i Bankës Popullore.

Neni 45

- (1) Kriteret dhe standardet për punën e sistemeve pagesore në pajtim me standardet ndërkombëtare të pranueshme i përcakton Këshilli i Bankës Popullore.
- (2) Për shkak të funksionimit efikas të sistemit pagesor, Banka Popullore mund të jep rekomandime me shkrim-këshilla, pjesëmarrësve në sistemin pagesor ose operatorit të sistemit pagesor për funksionimin në pajtim me standardet e përcaktuara dhe të përcaktojë afat të gjatë të cilave duhet të harmonizohen me rekomandimet.
- (3) Banka Popullore mund t'i ndalojë operatorit të sistemit pagesor që të jep shërbime në sistemin pagesor nëse nuk i respekton standardet dhe rekomandimet e përcaktuara nga ky nen.

Neni 46

- (1) Personat juridik të cilët janë inkuadruar në punën e sistemit pagesor ose kryejnë shërbime të tjera lidhur me pagesat, janë të detyruar që të dorëzojnë të dhëna nga aktivitetet e kryera në qarkullimin pagesor në Bankën Popullore.
- (2) Përmbajtjen, mënyrën dhe afatet e dorëzimit të të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton Këshilli i Bankës Popullore.

VI. SHLYERJET MIDIS BARTËSVE TË QARKULLIMIT PAGESOR

Neni 47

Barazimi midis bartësve të qarkullimit pagesor bëhet nëpërmjet sistemit për shlyerjen në Bankën Popullore.

Neni 48

Pagesat midis pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor të bartësve të ndryshëm të qarkullimit, konsiderohen si përfundimtare atëherë kur rezultati nga llogaria për përcaktimin e obligimeve të cilat dalin nga këto pagesa, bartësi i qarkullimit pagesor i shlyerjes në sistemin për shlyerjen në Bankën Popullore.

VII. RUAJTJA E DOKUMENTEVE

Neni 49

- (1) Bartësi i qarkullimit pagesor është i detyruar t'i ruajë instrumentet pagues dhe dokumentet tjera në bazë të të cilave janë evidentuar ndërrimet e llogarive të transaksioneve së paku 5 vjet pas skadimit të vitit kalendarik në të cilin janë evidentuar ndërrimet.
- (2) Të dhënat nga regjistri i llogarive të transaksionit ruhen përgjithmonë. Dokumentacioni në bazë të të cilit është hapur dhe mbyllur llogaria e transaksionit ruhet 5 vjet pas skadimit të vitit në të cilin llogaria e transaksionit është mbyllur.
- (3) Dokumentet dhe të dhënat nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni mund të ruhen në formën burimore ose në menyrë tjetër adekuate.

VIII. DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE

Neni 50

- (1) Gjobë në shumë prej 8.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje bartësit të qarkullimit pagesor nëse:
 - 1) nuk i siguron kushtet e percaktuara nga neni 4 i këtij Ligji;
 - 2) nuk mban regjistër të llogarive të transaksionit në sistemin e vet (neni 6, pika 2));
 - 3) lejon realizimin e pagesës e cila nuk është nëpërmjet llogarisë së transaksionit (neni 10, paragrafi (2));
 - 4) vepron në kundërshtim me mënyrën dhe procedurën e hapjes së llogarisë së transaksionit (neni 12, paragrafi(4));
 - 5) nuk e mbyll llogarinë e transaksionit nëse janë plotësuar kushtet, nuk e informon pjesëmarrësin në qarkullimint pagesor për heqjen e llogarisë së transaksionit ose nuk e respekton mënyrën dhe procedurën për hapjen dhe mbylljen e llogarisë së transaksionit (nenet 12 dhe 13);
 - 6) të dhënat për ndërrimet në regjistrin e tij të llogarive të transaksionit, nuk i dorëzon në regjistrin të vetëm të llogarive të transaksioneve në pajtim me nenin 15, paragrafi (1) nga ky Ligj;
 - 7) kryen pagesën sipas instrumentit pagesor nga llogaria e transaksionit në të cilën nuk ka mbulesë (neni 19 paragrafi (1));
 - 8) nuk vepron sipas aktvendimit për pagesë të detyruar më së voni ditën e ardhshme nga dita e pranimit të aktvendimit, aktvendimet për pagesë të detyruar nuk i evidenton sipas datës dhe kohës së arritjes së tyre ose nuk i kryen aktvendimet për pagesë të detyruar sipas radhitjes së tyre (neni 21);
 - 9) nuk bën konvertimin në denarë të mjeteve nga llogaria devizore me kurs mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila vlen ditën e transaksionit ose nuk bën bartjen e llogarisë në denarë të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor-debitor deri në shumën e duhur për realizim të plotë të aktvendimit për pagesë të detyruar (neni 22, paragrafi(4));
 - 10) nuk e bllokoi llogarinë ose nuk e dorëzon numrin tatimor të pjesëmarrësit – debitor nëpërmjet regjistrin të vetëm të llogarive të transaksioneve të bartësit tjerë të qarkullimit pagesor se nuk guxojnë të kryejnë pagesa nga mjetet e llogarive në denarë dhe atyre devizore të pjesëmarrësit – debitor deri në realizimin e plotë të aktvendimit për pagesë të detyruar (neni 22, paragrafi (5));
 - 11) pas përmbushjes së obligimeve sipas aktvendimit për pagesë të detyruar nuk e deblokoi llogarinë ose për zhblokimin e llogarisë nuk i informon bartësit tjerë të qarkullimit pagesor nëpërmjet regjistrin të vetëm të llogarive të transaksionit (neni 22, paragrafi(6));
 - 12) nuk e informon Regjistrin Qendror për llogarinë e transaksionit e cila është e bllokuar pa ndërprerë më shumë se 45 ditë (neni 24);

- 13) nuk e publikon tarifen për kompensim për kryerjen e punëve të qarkullimit pagesor në vend të dukshëm në lokalacionin dhe në ueb faqen e saj (neni 26, paragrafi (2));
- 14) me kërkesë të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor nuk i vë në dispozicion informata për kushtet e realizimit të qarkullimit pagesor ose për kushtet e realizimit të qarkullimit pagesor nuk mbajnë minimumin e informatave (neni 27);
- 15) aktvendimet për pagesë të detyruar që e detyrojnë llogarinë e Trezorit nuk i realizon me përgatitjen e urdhërpagesave për realizim të cilat i dorëzon për realizim në Trezor (neni 8, paragrafi (1));
- 16) nuk i kryen obligimet financiare të cilat dalin nga instrumentet pagesore në suazat e sistemit pagesor (neni 40, paragrafi (2), nënparagrafi 1) dhe
- 17) është pjesëmarrës në sistemin pagesor pa lidhjen e marrëveshjes së themelimit të sistemit pagesor ose është pjesëmarrës në sistemin pagesor pa lidhur marrëveshje me operatorin e sistemit pagesor (neni 41, paragrafi (1)).
- (2) Përveç gjobës për veprimet nga paragrafi (1), pikat 1), 6) dhe 8) të këtij neni, bartësit të qarkullimit pagesor do t'i shqiptohet edhe sanksion i kundërvajtës ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej tre deri në gjashtë muaj.
- (3) Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë të denarit, do t'i shqiptohet personit përgjegjës të bartësi i qarkullimit të paguar për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni.
- (4) Përveç gjobës për veprimet nga paragrafi (1), pikat 1), 6) dhe 8) të këtij neni personit përgjegjës të bartësi i qarkullimit pagesor do t'i shqiptohet edhe sanksioni kundërvajtës, ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri një vit.

Neni 51

- (1) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për pjesëmarrësin në qarkullimin pagesor mikro tregtar, prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë të denarit për pjesëmarrësin në qarkullimin pagesor tregtar i vogël, prej 2000 deri 3.000 euro në kundërvlerë të denarit për pjesëmarrës në qarkullimin pagesor tregtar i mesëm dhe prej 3.000 deri 4.000 euro në kundërvlerë të denarit për pjesëmarrësin në qarkullimin pagesor tregtar i madh do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:
- 1) Nuk e informon me shkrim bartësin e qarkullimit pagesor të cili ka llogari transaksioni të ndryshimeve të paraqitura statusore dhe ndryshimet tjera (neni 14);
- 2) nuk i paguan se paku ditën e ardhshme në llogarinë e vet të transaksionit mjetet e pranuar me paratë gatshme në çfarëdo baze (neni 20, paragrafi (3));
- 3) ka llogari transaksioni të bllokuar, ndërsa kryen pagesa me llogaritje (neni 25, paragrafi (1)).
- (2) Gjobë në shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni pjesëmarrësit në qarkullim pagesor-tregtar individ.
- (3) Krahas gjobës nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej tre muajve deri në një vit, ndërsa pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor nga paragrafi (2) i këtij neni do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje deri në një vit.
- (4) Gjobë në shumë prej 100 deri 300 euro në kundërvlerë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.
- (5) Krahas gjobës nga paragrafi (4) i këtij neni, personit përgjegjës të personit juridik nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri në gjashtë muaj.

Neni 52

- (1) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për mikro tregtar prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të vogël, gjobë në shumë prej 3.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të mesëm dhe gjobë në shumë prej 7.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të mëdhenj do t'i shqiptohet për

kundërvajtje personit juridik, nëse lëshon para elektronike ndërsa nuk ka leje të lëshuar nga guvernatori i Bankës Popullore.

(2) Krahas gjobës nga paragrafi (1) i këtij neni personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës, ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej tre muajve deri në dy vjet.

(3) Në rast kur kundërvajtja nga paragrafi (1) i këtij neni është kryer nga lakmia ose me kundërvajtjen është shkaktuar dëm më i madh pronësor, personit juridik do t'i shqiptohet gjobë më shumë të dyfishtë të shumës maksimale nga paragrafi (1) i këtij neni ose në raport me shumën e dobisë së shkaktuar ose të marrë pronësore, por më së shumti deri në shumën e dhjetëfishtë nga shuma e paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personi juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Krahas gjobës nga paragrafi (4) i këtij neni personit përgjegjës të personi juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri në një vit.

(6) Në rast kur kundërvajtja nga paragrafi (1) i këtij neni është kryer nga interesi vetjak është shkaktuar dëm më i madh pronësor për personin përgjegjës të personi juridik do t'i shqiptohet gjobë me shumë maksimale nga paragrafi (4) i këtij neni, ose në raport me shumën e dobisë së shkaktuar ose të marrë pronësore, por më së shumti deri në shumën e dhjetëfishtë nga shuma e paragrafit (4) të këtij neni.

(7) Gjobë në shumën prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni.

(8) Krahas gjobës për veprime nga paragrafi (1) i këtij neni personit fizik do t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalese për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej një viti.

(9) Për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni i kryer nga materializmi ose me të cilën shkaktohet dëm i madh pronësor, personit juridik, respektivisht, tregtarit individual do t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës i gjobës deri në shumën e dyfishtë nga paragrafi (7) i këtij neni ose në përmasa me lartësinë e përfitimit pronësor të shkaktuar ose të përfituar.

Neni 53

(1) Gjobë për kundërvajtje në shumë prej 8.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet emetuesit të parave elektronike nëse:

1) jep para elektronike pa lidhur marrëveshje për dhënien e parave elektronike (neni 29, paragrafi (1));

2) pronarit të parave elektronike nuk i mundëson pagesën e mbulesës së parave elektronike të dhëna ose pagesën nuk e bën në afat prej tetë ditëve nga pranimi i kërkesës për pagesë (neni 31, paragrafi (1));

3) për pagesë nga neni 31, paragrafi (1) të këtij Ligji paguan kompensim ose shpenzime tjera (neni 31 paragrafi (2));

4) pronarit të parave elektronike nuk i lejon qasje në informatat për bilancin dhe mbulesën për paratë elektronike të dhëna (neni 32);

5) nuk depoziton mjete në shumën se paku në lartësinë e obligimeve vijuese për paratë elektronike të dhëna ose depozitimet janë mjete likuide të rrezikut të lartë dhe/ose të ulet (neni 37, paragrafi (1)), dhe

6) kryen aktivitete tjera përveç dhënies së parave elektronike (neni 38, paragrafi (1)).

(2) Përveç gjobës për veprimet nga paragrafi (1), pikat 1), 3) dhe 5) të këtij neni, emetuesit të parave elektronike do t'i shqiptohet edhe sanksioni i kundërvajtës ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej tre deri në dy vjet.

(3) Gjobë në shumë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë të denarit, do t'i shqiptohet personit përgjegjës të emetuesit të parave elektronike për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Përveç gjobës për veprimet nga paragrafi (1) pikat 1), 3) dhe 5) të këtij neni personit përgjegjës të dhenësi i parave elektronike do t'i shqiptohet edhe sanksioni kundërvajtës, ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri në një vit.

Neni 54

(1) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për mikro tregtar, prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të vogël, gjobë në shumë prej 3.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të mesëm dhe prej 9.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të madh do t'i shqiptohet për kundërvajtje shtëpisë së kliringut nëse:

- 1) nuk mban regjistrë të vetëm të llogarive të transaksioneve (neni 15 paragrafi (2));
- 2) llogaritë e transaksioneve të regjistrit të vetëm të cilin e mban nuk i dorëzon në Trezor (neni 9, paragrafi (2));
- 3) nuk i kryen operimet e llogaritjes dhe përcaktimin e obligimeve dhe kërkesave të pjesëmarrësve në sistemin pagesor (neni 40, paragrafi (2), nënparagrafi 3);
- 4) është pjesëmarrës në sistemin pagesor pa lidhur marrëveshje për themelimin e sistemit pagesor ose është pjesëmarrës në sistemin pagesor pa lidhur marrëveshje me operatorin e sistemit pagesor (neni 41, paragrafi (1)), dhe
- 5) llogaritjen për përcaktimin e obligimeve nuk e kryen në pajtim me nenin 43 nga ky ligj.

(2) Krahës gjobës nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej tre muajve deri në një vit.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Krahës gjobës nga paragrafi (3) i këtij neni, personit përgjegjës të personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri në një vit.

Neni 55

(1) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për mikro tregtar, prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të vogël, prej 2.000 deri 4.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të mesëm dhe prej 4.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të madh do t'i shqiptohet operatorit të sistemit pagesor person juridik nëse:

- 1) nuk e informon Bankën Popullore për fillimin me punë (neni 41 paragrafi (2));
- 2) nuk përcakton rregullatë sistemit pagesor (neni 42 paragrafi (1));
- 3) nuk e respekton ndalesën e Bankës Popullore (neni 45 paragrafi (3)).

(2) Gjobë në shumë prej 200 deri 400 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personi juridik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 56

(1) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për mikro tregtar, prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të vogël, prej 1.500 deri 2.500 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të mesëm dhe prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të madh të përfshirë në punën e sistemit pagesor ose i cili kryen shërbime të tjera lidhur me pagesat, do t'i shqiptohet personit juridik nëse në Bankën Popullore nuk dorëzon të dhëna nga aktivitetet e kryera në qarkullimin pagesor (neni 46, paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 100 deri 300 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 56-a

(1) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për ndërmjetësuesin gjatë mikro pagesës mikro tregtar, prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë të denarit për ndërmjetësuesin gjatë mikro pagesës për tregtar të vogël, prej 1.500 deri 2.500 euro në kundërvlerë të denarit për ndërmjetësuesin gjatë mikro pagesës për tregtar të mesëm dhe prej

2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë të denarit për ndërmjetësuesin gjatë mikro pagesës për tregtar të madh do t'i shqiptohet personit juridik nëse:

1) nuk e njohton Bankën Popullore në pajtim me nenin 27-v të këtij ligji, dhe

2) nuk u përmbahet limiteve të përcaktuara në këtë ligj.

(2) Krahas gjobës nga paragrafi (1) i këtij neni ndërmjetësuesit gjatë mikro pagesës do t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej gjashtë muajve.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri 300 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personi juridik për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Krahas gjobës nga paragrafi (3) i këtij neni, personit përgjegjës të personi juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje prej tre muajve deri në gjashtë muaj.

Neni 56-b

(1) Gjobë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për mikro tregtar, prej 1.500 deri 2.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të vogël, prej 3.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të mesëm dhe prej 8.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të madh do t'i shqiptohet personit juridik i cili punon në ndërmjetësim gjatë mikro pagesave pa pëlqimin e guvernatorit të Bankës Popullore.

(2) Krahas gjobës nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej tre muajve deri në dy vjet.

(3) Në rastin kur kundërvajtja nga paragrafi (1) i këtij neni është kryer nga lakmia ose me kundërvajtjen është shkaktuar dëm më i madh pronësor, personit juridik do t'i shqiptohet gjobë në shumë të dyfishtë të shumës maksimale nga paragrafi (1) i këtij neni ose në raport me shumën e dobisë së shkaktuar ose të marrë pronësore, me më së shumti deri në shumën e dhjetëfishtë nga shuma e paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik përkatësisht tregtarit-individ i cili kryen punë të ndërmjetësimit gjatë mikropagesave në pajtim me guvernatorin e Bankës Popullore.

(5) Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Krahas gjobës nga paragrafi (5) i këtij neni, personit përgjegjës të personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion i kundërvajtës ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri në një vit.

(7) Në rast kur kundërvajtja nga paragrafi (1) i këtij neni është kryer nga lakmia ose me kundërvajtjen është shkaktuar dëm më i madh pronësor, personit përgjegjës të personi juridik do t'i shqiptohet gjobë me shumë të dyfishtë të shumës maksimale nga paragrafi (5) i këtij neni ose në raport me shumën e dobisë së shkaktuar ose të marrë pronësore, por më së paku deri në shumën e dhjetëfishtë nga shuma e paragrafeve (4) dhe (5) të këtij neni.

Neni 56-v

Shlyhet

Neni 56-g

Për kundërvajtjet të përcaktuara me këtë Ligj, procedura kundërvajtëse mban edhe sanksion kundërvajtës, shqipton gjykata kompetente

Neni 56-d

(1) Për kundërvajtje të përcaktuar me këtë Ligj, personat të cilët janë të autorizuar për kontroll para se të parashtrajnë kërkesë për procedure kundërvajtëse janë të obliguar kryerësit të

kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë të shlyerjes me lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes/

- (2) Nëpunësit e autorizuar zyrtar janë të obliguar të mbajnë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara kundërvajtëse dhe për epilogun e procedurave të ngritura.
- (3) Të dhënat personale nga paragrafi (2) i këtij neni, ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.
- (4) Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhër pagesës kundërvajtëse.

Neni 56-gj

Matja e shumës së gjobës kryhet në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes.

IX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 57

Bartësit e qarkullimit pagesor janë të detyruar të gjitha llogaritë e transaksionit t'i paraqesin në Regjistrin e Vetëm të llogarive të transaksioneve më së voni deri në 31 dhjetor 2007.

Neni 58

Urdhëresat akceptuese të dhëna deri në fund të 30 qershorit 2001 do të realizohen deri në pagesën e plotë të tyre.

Neni 59

Obligimin nga neni 11 i këtij Ligji, bankat janë të detyruara ta bëjnë më së voni deri më 31 dhjetor 2008.

Neni 60

Pjesëmarrësit në sistemet pagesore dhe operatore të sistemeve pagesore që tani më punojnë, janë të detyruar ta paraqesin punën e tyre në Bankën Popullore në afat prej 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 61

Dispozitat nënligjore që dalin nga ky ligj do të miratohen më së voni deri më 31 dhjetor 2007.

Neni 62

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, pushon së vlejti Ligji për Qarkullimin Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 32/2001, 50/2001, 52/2001, 103/2001, 37/2002, 41/2002, 61/2002, 42/2003 dhe 13/2006).

Neni 63

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" ndërsa do të zbatohet nga 1 janari 2008.

Dispozitat e këtij ligji nuk vlejnë për pagesën e taksave administrative dhe gjyqësore përmes operatorëve celularë dhe për pagesat në shuma individuale deri në 300 denarë.

Aktet nënligjore të parashikuara nga ky ligj do të miratohen brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. ⁶

Procedurat kundërvajtëse të iniciuara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave të Ligjit për transaksionet pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/2007, 22/2008, 159/2008, 133/ 2009, 145/10, 35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/13, 153/15, 199/15, 193/17 dhe 7/19) ⁷.

⁶ Këto dispozita paraqesin nenin 4 dhe nenin 5 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Qarkullimit Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 166/12) dhe i referohen dispozitave që plotësohen me këtë ndryshim.

⁷ Kjo dispozitë paraqet nenin 15 të Ligjit të Qarkullimit Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 24/20).